# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452835**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kurti takim me kreun e PDK pas verdiktit të Hagës: Vendimi duhet të përmbyset në Apel |
| ADRESA | `https://tpz.al/kurti-takim-me-kreun-e-pdk-pas-verdiktit-te-hages-vendimi-duhet-te-permbyset-ne-apel-i333190` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 16:06:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 15:52:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `aa22218d0acfe411a2475fe4d3320325e0cdb9e75ef3677b850ae090fed8fe3f` |
| TEKSTI | `1fc5b8bf4c14d9b1d1e44954033838dbace4d6bd12ac44f3d0f055415df78f93` |
| PAMJA | `02853d50daf20d437d363b8ca9834179209afb7ffdc87a7781dad08054d6affe` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a9cc95d872805a649f68ded5cac34af330bf3b2c9faf40ea83edfd25042d2657` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a9cc95d872805a649f68ded5cac34af330bf3b2c9faf40ea83edfd25042d2657`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 17 SEPTEMBER 2026, 17:52

# Kurti takim me kreun e PDK pas verdiktit të Hagës: Vendimi duhet të përmbyset në Apel

TPZ



Tronditja e shkaktuar nga shpallja e aktgjykimit të shkallës së parë nga Dhomat e Specializuara në Hagë ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bërë bashkë pushtetin dhe opozitën në Prishtinë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur sot në një takim kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Në fokus të diskutimeve mes dy liderëve ishte verdikti i Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilin ekzekutivi i Kosovës e ka cilësuar si një goditje me pasoja të rënda administrative, gjeopolitike dhe kombëtare.

Gjatë takimit, Kurti dhe Hamza analizuan hapat ligjorë dhe gjeopolitikë që duhet të ndërmerren për të kërkuar korrigjimin e vendimit në shkallët e mëtejshme procedurale. Kryeministri Kurti nënvizoi se ky aktgjykim nuk mund të mbetet në fuqi dhe kërkon reagim institucional. Sipas njoftimit zyrtar të Zyrës së Kryeministrit: "Duke e vlerësuar aktgjykimin të padrejtë, të rëndë dhe me pasoja të gjera, kryeministri Kurti theksoi se ai duhet ndryshuar pozitivisht në shkallën e Apelit."

Përveç koordinimit për mbrojtjen e trashëgimisë së luftës, Kurti dhe Hamza u zotuan të mbajnë një linjë të drejtpërdrejtë dhe të rregullt komunikimi për çështjet me interes të lartë publik, shtetëror dhe kombëtar. Reagimi zyrtar nga Prishtina ka risjellë në vëmendje legjitimitetin e luftës çlirimtare përballë aparatin shtypës të Serbisë. Ekzekutivi nënvizoi se rezistenca e armatosur e popullit të Kosovës ishte një e drejtë e pamohueshme përballë dhunës shtetërore sistematike.

"Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përgjigje organizative e shqiptarëve ndaj një regjimi shtetëror shtypës sikurse ai i Jugosllavisë së Serbisë së Millosheviqit, që i ka të dokumentuara krimet: nga represioni sistematik deri te aparteidi, nga mohimi i të drejtave themelore njerëzore e qytetare deri te spastrimi etnik dhe gjenocidi", thuhet në deklaratën e Qeverisë.

## ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

## Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

## Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

## Moti

Tirana, Albania

## WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

BALLKAN / 17 September 2026, 16:25

**FAZ ngre pikëpyetje për dënimet ndaj ish-krerëve të UÇK-së: A janë proporcionale me ato të kriminelëve serbë të luftës?**

BALLKAN / 17 September 2026, 15:45

**"Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi"/ Përlotet vajza e Jakup Krasniqit: Ja mesazhi që na ka lënë**

BALLKAN / 17 September 2026, 15:24

**Gjykata Speciale, Hamza paralajmëron hapa konkretë: Do të takohem me liderët politikë, PDK ka gati 22 nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme**

BALLKAN / 16 September 2026, 22:55

**"Vendimi i Hagës, shokues" - Edward P. Joseph: Serbia do ta përdorë për të diskretituar UÇK-në**

BALLKAN / 16 September 2026, 22:07

**Pas vendimit të Hagës, reagon për herë të parë djali i Hashim Thaçit: Historinë e UÇK-së nuk mund ta ndryshojë asnjë vendim**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:57

**"Jam i shokuar dhe i zemëruar" - Ish-komandanti i NATO-s: Nuk kam parë asnjë dëshmi që të justifikojë dënimin e krerëve të UÇK-së**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:37

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Dua Lipa dhe Rita Ora në mbështetje të Çlirimtarëve**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:19

**Hagë/ Kryeprokurorja West: Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, i rëndësishëm për drejtësinë ndaj viktimave**

BALLKAN / 16 September 2026, 21:01

Organizata për të Drejtat e Njeriut: Aktgjykimi i Speciales, moment i rëndësishëm për viktimat

BALLKAN / 16 September 2026, 20:23

"UÇK-ja nuk ishte në gjyq" – Franca dhe Gjermania reagojnë pas vendimit të Hagës: Aktgjykimi nuk shfajëson krimet e regjimit jugosllav

BALLKAN / 16 September 2026, 20:00

Dënimi i ish-liderëve të UÇK, deputetja e PDK thirrje për nisjen e procedurave institucionale për zhbërjen e Gjykatës Speciale

BALLKAN / 16 September 2026, 19:14

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Vuçiç reagon: Haga rrëzoi 6 akuza për krime, nuk u provuan sulme sistematike

BALLKAN / 16 September 2026, 18:42

Mediat në Kosovë: Nis mbledhja e nënshkrimeve të deputetëve për zhbërjen e Gjykatës Speciale

BALLKAN / 16 September 2026, 18:19

Haga jep 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, ja si mund të apelohet vendimi i Speciales

BALLKAN / 16 September 2026, 18:01

Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, reagon zv.kryeministri shqiptar i

BALLKAN / 16 September 2026, 17:41

Protestat në Hagë, policia tregon detajet: Dy të arrestuar dhe një efektiv i lënduar

Malit të Zi: Vendim jashtëzakonisht i padrejtë!

BALLKAN / 16 September 2026, 17:35

## Marta Kos pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Duhet respektuar drejtësia, përgjegjësia është individuale

BALLKAN / 16 September 2026, 17:27

## Kreu i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut: Pavarësisht vendimit, katërshja e UÇK-së mbeten çlirimtarë të Kosovës

BALLKAN / 16 September 2026, 17:08

## Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, Kroacia del në mbështetje të Kosovës: Ishte viktimë e krimeve të Millosheviçit!

BALLKAN / 16 September 2026, 15:48

## "Thaçi dhe Veseli e morën me pranga"/ Gjykata e Hagës për zhdukjen e Behajdin Allaqit 28 vite më parë: Jemi të bindur se ai u vra, në komunikatë thanë se ra dëshmor

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES NJOFTIME NGA TPZ.AL

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE
SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE

Built & Monetized by Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.